

**Pasqyrat Financiare të Konsoliduara
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Alumil Albania Sh.p.k.
(së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur)**

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Drejtimin dhe Ortakëve të Shoqërisë "ALUMIL-ALBANIA" sh.p.k

Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara

Opinionin me rezerva

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë "ALUMIL-ALBANIA" sh.p.k. (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2022, dhe pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, duke përjashtuar efektet e mundshme të çështjes së përshkruara në seksionin e raportit tonë "Baza e Opinionit me rezerva", pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin e konsoliduar financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2022 si dhe pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe flukset e konsoliduar të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza e Opinionit me rezerva

1. Sikurse është shënuar në shënimin 2.1 të pasqyrave financiare të konsoliduara, Shoqëria në pasqyrat financiare të konsoliduara që mbyllet me 31 dhjetor 2022, ka implementuar për herë të parë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Shoqëria ka zgjedhur që efektet që lindin nga aplikimi për herë të parë i SNRF-ve të raportohen në pasqyrat financiare të konsoliduara të vitit që mbyllet me 31 dhjetor 2022 pa kryer modifikime në pasqyrat e vitit që mbyllet me 31 dhjetor 2021 dhe 2020, praktikë e cila nuk është në përputhje me kërkesat e SNRF-ve. Si rezultat i kësaj çështjeje, ne nuk jemi në gjendje të percaktojmë rregullimet e nevojshme që do ishin kryer në pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital, pasqyrën e konsoliduar të rrjedhës së parasë për vitin që mbyllet me 31 dhjetor 2022 dhe pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të konsoliduara. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Të dhëna të tjera

Drejtimi është përgjegjës për të dhëna të tjera. Të dhënat e tjera konsistojnë në të dhëna të përfshira në raportin vjetor, përgatitur nga Drejtimi, në përputhje me Nenin 17 dhe 19 të Ligjit nr. 25/2018 "Të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare", i ndryshuar, por nuk përfshin Pasqyrat Financiare të konsoliduara dhe Raportin tonë të Auditimit. Raporti vjetor pritet të jetë i disponueshëm për ne, pas datës së këtij Raporti të Audituesit të Pavarur. Opinioni jonë mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nuk mbulon të dhëna të tjera dhe ne nuk shprehim asnjë formë opinioni mbi to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare të konsoliduara, përgjegjësia jonë është të lexojmë të dhënat e tjera të identifikuar më lart, kur këto të dhëna të jenë të disponueshme dhe, duke e bërë këtë, të konsiderojmë nëse informacioni tjetër nuk është material në kundërshtim me pasqyrat financiare të konsoliduara apo njohuritë tona të marra gjatë auditimit, ose në të kundërt nëse është material. Gjatë rishikimit të raportit vjetor, nëse konstatojmë se ekziston një gabim material në të, nga ne kërkohet që t'ua komunikojmë çështjen drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare të konsoliduara.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne, gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijmësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare të konsoliduara, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Kreston Albania Sh.p.k.

Rruga Muhamet Gjollësja, shk. B, K. 6, Ap. B-6

Pranë Qendrës Tregtare Ring Tirane Shqipëri, 1001

Numri I Identifikimit të Personit të Tatuësëm L42007012I

NUIS L42007012I

Rezar LLUKAÇEJ

Auditues Ligjor

Partner Angazhimi

Tirana, 17 maj, 2023



PËRMBAJTJA

OPINIONI I AUDITUESIT TE PAVARUR
PASQYRA E KONSOLIDUAR E PERFORMANCËS
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSEVE TË PARASË

1.	INFORMACION I PERGJITHSHËM	5
2.	PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL	5
2.2	Baza e përgatitjes	5
2.3	Monedha funksionale dhe raportuese.....	6
2.4	Transaksionet në monedhë të huaj	6
2.5	Të ardhurat nga kontratat me klientët.....	6
2.6	Tatimi mbi të ardhurat	7
2.7	Aktivët afatgjata materiale	8
2.8	Aktivët jo-materiale.....	9
2.9	Qiratë	9
2.10	Inventarët	9
2.11	Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare	9
2.12	Instrumentat financiarë (vazhdim).....	11
2.13	Përfitimet e punonjësve.....	13
2.14	Provizjonet	13
2.15	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	13
2.16	Përcaktimi i vlerës së drejtë.....	13
3.	GJYKIME TË RËNDËSISHME KONTABËL, VLERËSIME DHE SUPOZIME.....	14
4.	TË ARDHURA NGA KONTRATAT ME KLIENTËT	15
5.	TË ARDHURA TË TJERA	15
6.	KOSTO E MALLRAVE TE SHITUR	16
7.	SHPENZIME PER MATERIALE.....	16
8.	SHPENZIME PER SHERBIME.....	16
9.	SHPENZIME PER PAGA DHE DETYRIME	16
10.	SHPENZIME TE TJERA.....	17
15.	AKTIVE AFATGJATA MATERIALE	19
16.	AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE	20
17.	AKTIVE AFATGJATA FINANCIARE	20
18.	INVENTARI	20
18.	INVENTARI (VAZHDIM).....	21
19.	LLOGARI TË ARKËTUESHME	21
20.	LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME	21
21.	MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTE TË TYRE	22
22.	Kapitali aksionar	22
23.	REZERVA.....	22
24.	HUAMARRJE	22
25.	LLOGARI TË PAGUESHME	23
26.	LLOGARI TE TJERA TE PAGUESHME.....	23
27.	TATIMI MBI FITIMIN PER TU PAGUAR.....	23
28.	PALËT E LIDHURA	24
29.	OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT E MENAXHIMIT TË RISKUT FINANCIAR	25
30.	ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA	27
31.	NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT	27

Alumil Albania Sh.p.k.*(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E KONSOLIDUAR E PERFORMANCËS
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Te Ardhura nga Shitja e Produkteve te Gatshme	5	2,670,277,026	2,140,358,020
Te ardhura nga Shitja e mallrave dhe materialeve	5	524,434,835	469,696,533
Te Ardhura nga Shitja e Nenprodukteve	5	129,361,144	81,997,597
Te Ardhura nga Shitja e Sherbimeve	5	13,878,628	6,372,771
Totali i të ardhurave nga kontratat me klientët		3,337,951,633	2,698,424,921
Të ardhura të tjera	6	30,754,063	11,320,958
Totali i të ardhurave		3,368,705,696	2,709,745,879
Ndryshim I Gjendjes se Inventarit	7	36,937,453	215,806,238
Kostot e shitjeve	7	(2,453,108,638)	(2,004,799,950)
Shpenzime për materiale	8	(73,959,436)	(52,019,064)
Shpenzime për shërbime	9	(182,725,788)	(200,512,466)
Shpenzime për paga dhe sig.shoq dhe shend	10	(360,542,410)	(328,932,387)
Shpenzime të tjera	11	(30,506,164)	(16,008,613)
Amortizime dhe zhvlerësime		(153,461,256)	(118,758,038)
Fitim/(humbje) nga këmbimet valutore, neto	12	(13,247,706)	(6,894,717)
Totali i shpenzimeve		(3,230,613,945)	(2,512,118,997)
Shpenzime financiare, neto	13	(18,305,644)	(1,911,202)
Fitimi para tatimit		119,786,107	195,715,680
Tatim korrent mbi fitimin	14	(26,525,653)	(34,659,617)
Shpenzime nga tatim fitimi i shtyrë	15	(4,924,132)	(4,380,099)
Fitimi neto për vitin		88,336,322	156,675,964
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		88,336,322	156,675,964

Shënimet shpjeguese mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara në faqet nga 5 në 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.



Alumil Albania Sh.p.k.

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR
Më 31 dhjetor 2022

Shënime	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Aktivet		
Aktivet afatgjata		
Aktive afatgjata materiale	16 1,065,907,909	1,140,684,449
Aktive afatgjata jomateriale	17 1,057,862	940,458
Aktive Tatimore te Shtyra	18 13,391,135	18,315,267
E drejta e perdorimit	19 36,447,770	-
Aktive financiare afatgjata	20 3,034,652	2,620,468
Totali i aktiveve afatgjata	1,119,839,328	1,162,560,642
Aktivet afatshkurtra		
Inventari	21 916,292,498	758,999,197
Llogari te Arketueshme	22 104,173,125	187,264,958
Te tjera te Arketueshme	23 87,117,013	20,111,523
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	24 131,753,698	114,401,509
Totali i aktiveve afatshkurtra	1,239,336,334	1,080,777,187
Totali i aktiveve	2,359,175,662	2,243,337,829
Kapitali dhe Detyrimet		
Kapitali		
Kapitali aksionar	25 1,476,303,018	1,476,682,330
Fitimi i mbartur	635,597,852	538,012,601
Rezerva	26 16,309,452	16,309,452
Totali i kapitaleve të veta	2,128,210,322	2,031,004,383
Detyrimet		
Detyrimet afatgjata		
Detyrim per qiramarrjen financiare	27 24,004,794	-
Totali i detyrimeve afatgjata	24,004,794	-
Detyrimet afatshkurtra		
Llogari te Pagueshme	28 41,084,306	104,556,365
Te tjera te Pagueshme	29 40,798,553	32,962,781
Huamarrje Afatshkurtra	30 109,873,730	60,380,000
Detyrim per qiramarrjen financiare	27 13,144,381	-
Tatim Fitimi I pagueshem	31 2,059,576	14,434,300
Totali i detyrimeve afatshkurtra	206,960,546	212,333,446
Totali i detyrimeve	230,965,340	212,333,446
Totali i detyrimeve dhe kapitalit	2,359,175,662	2,243,337,829

Këto pasqyra financiare të konsoliduara të konsoliduara dhe shënimet shpjeguese mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara në faqet nga 5 në 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara, të autorizuar nga drejtimi më 01.03.2023 dhe nënshkruar në emër të tij nga:

Georgios Batsakis
Administrator



Dorian Memo
Drejtor Finance

Dorian Memo

Alumil Albania Sh.p.k.

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

**PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL
Më 31 dhjetor 2022**

	Kapitali themeltar	Diferenca të perealizuara të këmbimit	Rezerva Statutore	Fitimi i mbartur	Totali i kapitalit
Gjendja më 1 janar 2021	1,481,601,000	(5,097,749)	16,309,452	372,833,995	1,865,646,698
Shpërndarja e dividendit	-	-	-	-	-
Zvogëlim në kapital	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin	-	-	-	156,675,963	156,675,963
Diferenca të perealizuara të këmbimit	-	179,079	-	8,502,643	8,681,722
Gjendja më 31 dhjetor 2021	1,481,601,000	(4,918,670)	16,309,452	538,012,601	2,031,004,383
Shpërndarja e dividendit	-	-	-	-	-
Zvogëlim në kapital	-	-	-	-	-
Adjustment efekti kursit te kembimit	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin	-	-	-	88,336,322	88,336,322
Diferenca të perealizuara të këmbimit	-	(379,312)	-	9,248,929	8,869,617
Gjendja më 31 dhjetor 2022	1,481,601,000	(5,297,982)	16,309,452	635,597,852	2,128,210,322

Shënimet shpjeguese mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara në faqet nga 5 në 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.



Alumil Albania Sh.p.k.*(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSEVE TË PARASË**
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Flukset e parasë nga veprimtaritë shfrytëzuese		
Fitimi para tatimit	114,861,975	191,335,581
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizimi dhe zhvlerësimi i aktiveve afatgjata	153,461,256	118,758,038
Provizjoni i inventarit	(1,837,974)	(5,893,176)
Fitimi nga shitja e aktiveve afatgjata	5,052,120	130,058
Përdorim i materialeve për qëllime të brendshme	(9,539,312)	(2,993,188)
Shpenzime interesi	(14,774,651)	(1,911,202)
Diferenca nga Kursi I Kembimit	8,869,617	8,681,722
Ndryshimet në kapitalin qarkullues:		
Ndryshimi në llogaritë e arkëtueshme afatgjata	4,509,948	1,759,631
Ndryshimi në llogaritë e arkëtueshme	16,086,343	(73,681,660)
Ndryshimi në inventarë	(145,916,015)	(259,508,091)
Ndryshimi në llogaritë e pagueshme dhe të tjera	(68,011,011)	126,237,994
Interes i paguar	14,774,651	1,911,202
Tatimi fitimi i paguar	(26,525,653)	(34,659,617)
Flukset e gjeneruara nga veprimtaritë e shfrytëzimit	51,011,294	70,167,292
Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese		
Blerje e aktiveve afatgjata jo materiale	(117,404)	61,328
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(78,684,716)	(49,475,581)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	(5,052,120)	(130,058)
Flukset e përdorura për veprimtaritë investuese	(83,854,240)	(49,544,311)
Flukset e parasë nga veprimtaritë financuese		
Pagesa e principalit për te drejten e përdorimit	701,405	-
Pagesa të huave të marra	49,493,730	(1,470,000)
Flukset e përdorura në veprimtaritë financuese	50,195,135	(1,470,000)
Rritja e parasë në arkë dhe në bankë	17,352,189	19,152,981
Paraja në arkë dhe në bankë më 1 janar	114,401,509	95,248,528
Paraja në arkë dhe në bankë më 31 dhjetor	131,753,698	114,401,509

Shënimet shpjeguese mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara në faqet nga 5 në 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.



(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

1. INFORMACION I PERGJITHSHËM

Shoqëria Alumil Albania sh.p.k. ("Shoqëria" ose "Alumil Albania") është themeluar me datë 17 Gusht 1998 me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr.19911, dt.17.08.1998. Aksionerët themelues të shoqërisë janë:

PERBERJA E KAPITALIT AKSIONAR	Vlere Kapitali	% Kapitali
1 ALUMIL GROUP LTD	1,470,222,000	99.23%
2 Jeorjios Salpingjidhis	4,564,500	0.31%
3 Joanis Bulios	2,236,500	0.15%
4 Sotirios Bulios	2,148,000	0.14%
5 Georgios Mylonas	810,000	0.05%
6 Evangjelia Mylonas	810,000	0.05%
7 Majlinda Kalludhi me dy femijet e saj Enea dhe Dhimitra Kalludhi	810,000	0.05%
Total	1,481,601,000	100.00%

Aktiviteti i shoqërisë rregullohet me Ligjin nr. 9901 date 14.04.2016 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe nga statuti, si dhe nga legjislacioni shqiptar. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është: Prodhimi dhe Import-Eksporti i profileve të aluminit, aksesorëve dhe paisjeve të tjera për prodhimin e profileve.

Më 31 Dhjetor 2022, Shoqëria operon nga selia qendrore në Tirane, me adrese Autostrada Tirane-Durres, km.7, dhe në gjashtë magazina në rrethe.

Administrator i Shoqërisë është Z. Georgios Batsakis, me afat emërimi deri në 21 Janar 2023.

Numri mesatar i punonjësve të Shoqërisë për 2022 është 221 punonjes (2021: 220 punonjes).

Shoqëria, e cila është në pronësi, Shoqëria e Kufizuar "ALUMIL KOSOVO" ka filluar aktivitetin e saj më datë 121.05.2009 dhe numri i biznesit është 70579200. Veprimtaria e kësaj shoqërie është e rregulluar me ligjin nr. 02/L-123, datë 27.09.2007, "Për shoqëritë tregtare" dhe me statutin e saj dhe legjislacionin e Kosovës në fuqi.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL

2.1 Baza e përputhshmërisë

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Shoqërisë janë përgatitur në bazë të Standardeve Nderkombëtare të Raportimit Financiar ("IFRS").

Shoqëria ka zgjedhur si datë për implementim e parë të SNRF-së 1 janar 2022. Të gjitha veprimet rregulluese që lidhen me implementimin për herë të parë të SNRF-ve janë reflektuar në pasqyrat financiare më dhe për vitin që mbyllet me 31 dhjetor 2022. Efekti i veprimeve rregulluese që lidhen me implementimin për herë të parë të SNRF -ve lidhet me implementimin e kërkesave të SNRF 16, SNRF 39, SNRF 15, SNK 12 dhe SNRF 1.

2.2 Baza e përgatitjes

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike.

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.3 Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare të konsoliduara të konsoliduara janë paraqitur në Lekë Shqiptar ("lekë"), e cila është në të njëjtën kohë edhe monedha funksionale e Shoqërisë. Me përjashtim të rasteve kur është specifikisht e shprehur, informacioni financiar i shprehur në lekë është rrumbullakosur në mijëshe.

2.4 Transaksionet në monedhë të huaj

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale (monedha të huaja) rregjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës së raportimit. Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë që janë të rregjistruara në monedhë të huaj, rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

Diferencat që rezultojnë nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj me kurs të ndryshëm nga ato që janë konvertuar në njohjen fillestare gjatë periudhës ose në pasqyra të mëparshme financiare, njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, në periudhën që ato krijohen. Kurset e mëposhtme janë aplikuar gjatë vitit:

	Kursi mesatar		Kursi në datën e raportimit	
	2022	2021	2022	2021
USD / LEK	113.14	103.54	107.05	106.54
EUR / LEK	118.92	122.44	114.23	120.76

2.5 Të ardhurat nga kontratat me klientët

Shoqëria është e angazhuar në prodhimin e profileve të aluminit dhe aksesoreve të tyre dhe shitjen me shumicë dhe pakicë tek Tregëtarët apo perpunuesit e këtyre profileve. Gjithashtu Shoqëria ofron dhe shërbimet e ljerjes së profileve tek palet e treta por njekohesisht dhe shitjen dhe perpunimin e Skrapit të krijuar nga perpunimet e saj teknologjike.

Të ardhurat nga shitja e produkteve të gatshme

Shoqëria është e angazhuar me shitjen e profileve të aluminit të prodhuar apo dhe rishitja e profileve të blere tek klientet e saj. Njekohesisht Shoqëria është e angazhuar në shitjen e Skrapit industrial të krijuar nga procesi i prodhimit tek Shoqëria e saj meme Alumil S.A. Këto produkte faturohen mbi bazën e një liste çmimesh të përcaktuar.

Të ardhurat kryesore nga shitja produkteve të gatshme janë si më poshtë:

- Të ardhura nga shitja e profileve dhe aksesoreve të prodhuar;
- Të ardhura nga shitja e profileve dhe aksesoreve të blere për rishitje;
- Të ardhura nga shitja e materialeve të tjera për perpunim dhe Skrap;

Produkti i shitur mund të dallohet në mënyrë individuale dhe ka një çmim të dallueshëm i cili është lehtësisht i identifikueshëm. Çmimi i shitjes mund të identifikohet lehtësisht në kontratat e shitjes bazuar në çmimet e publikuara në magazinat nga ana e Shoqërisë por njekohesisht dhe kontratave të lidhura midis Shoqërisë dhe paleve të treta. Rrjedhimisht Alumil Albania ka alokuar çmimin e transaksionit për secilin produkt në baza individuale. Përgjithësisht Shoqëria për pjesën e shitjeve të sipër përmendura operon me pagesa të menjëhershme dhe pagesa të prithsme në momentin e dorëzimit të produktit tek klienti.

Të ardhurat e mësipërme llogariten në bazë të numrit të artikullit të shitur, listës së çmimeve të paracaktuar dhe njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes kur ndodhin. Shoqëria njeh shitjet në momentin e transferimit të produkteve tek klienti, pra kur të gjitha perfitimet dhe rreziqet e produktit si dhe kontrolli mbi produktin i kalojnë klientit në momentin e faturimit.

Shoqëria nuk ka kontrata dhe shitje që kanë faktorë variabël për t'u konsideruar si psh., penalitet për vonesa në dërgime të produkteve, përfitime për shlyerje brenda një afati të paracaktuar, ndryshime në çmime të shitjes që nuk kreditohen nga furnitori etj.

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.5 Të ardhurat nga kontratat me klientët (vazhdim)

Të ardhura të tjera nga kontratat me klientët

Shoqëria si pjesë të aktivitetit të saj, përfiton të ardhura edhe nga shitjet e mëposhtme të cilat mund të identifikohen si detyrime performance të vecanta të kategorizuara si më poshtë:

- Të ardhura nga shërbimet e lyerjes se profileve;
- Të ardhura Transporti;

Të ardhura shërbimet e lyerjes se profileve

Shoqëria njëkohësisht nga Klientet e saj përfiton të ardhura dhe nga ofrimi i shërbimit të lyerjes se profileve jo të saj Produkti i shitur mund të dallohet në mënyrë individuale dhe ka një çmim të dallueshëm i cili është lehtësisht i identifikueshëm. Çmimi i shitjes mund të identifikohet lehtësisht në kontratat e shitjes bazuar në çmimet e publikuara në magazinat nga ana e Shoqërisë por njëkohësisht dhe kontratatave të lidhura midis Shoqërisë dhe paleve të treta. Rrjedhimisht Alumil Albania ka alokuar çmimin e transaksionit për secilin produkt në baza individuale.

Të ardhura nga Transporti

Të ardhura nga transporti janë të ardhura që përfitohen ofrimin e shërbimit të transportit që shoqëria kryen për disa nga klientet e saj, referuar dhe kontratatave të shitjeve që ajo ka.

Shoqëria ka arritur në përfundimin që është në rolin kryesor në kontratat e shitjes të sipërpërmendura sepse ajo kontrollon këto produkte, shërbime apo njësi ndërtimore përpara transferimit tek klienti, ka aftësi të përcaktojë çmimin si dhe mban të gjitha risqet dhe përfitimet në raste dështimi, dëmtimi apo mospërbushje të kushteve të kontratës.

Aktiv i kontratës

Një aktiv i kontratës me klientët është e drejta për pagesë në shkëmbim të produkteve apo shërbimeve të transferuar tek klientët.

Nëse Shoqëria përmbush duke transferuar produkte apo shërbime tek një klient përpara se ai të paguajë apo përpara se pagesa të jetë e detyrueshme, njihet një aktiv i kontratës për pagesa që do përfitohen por janë të kushtëzuara nga performanca e Shoqërisë.

Të drejta të arkëtueshme

Një e arkëtueshme përfaqëson të drejtën e Shoqërisë për një shumë të konsiderueshme të pakushtëzuar (d.m.th. vetëm kalimi i kohës kërkohet përpara se pagesat e shumës të jenë të detyrueshme).

Detyrimi i kontratës

Një detyrim i kontratës është një detyrim për të transferuar mallra ose shërbime tek një klient për të cilat Shoqëria ka marrë një shumë nga klienti. Nëse një klient paguan këtë shumë përpara se Shoqëria të transferojë mallra ose shërbime tek klientit, një detyrim kontrate njihet kur pagesa është bërë ose e detyrueshme për t'u kryer (cilado që është më herët). Detyrimet e kontratës njihen si të ardhura kur Shoqëria përmbush apo realizon detyrimin e kontratës.

2.6 Tatimi mbi të ardhurat

Tatim mbi të ardhurat

Tatimi mbi të ardhurat për periudhën aktuale matet me shumën që pritet të rimerret ose paguhet nga autoritetet tatimore. Legjislacioni tatimor i përdorur për të llogaritur shumën e tatimit mbi fitimin janë ato në fuqi ose që konsiderohen të tilla, në datën e raportimit në vendet ku Shoqëria operon dhe gjeneron të ardhura të tatueshme.

Tatimi aktual mbi të ardhurat lidhur me njësitë që njohen drejtpërdrejtë në kapitalin neto, njihet në kapital dhe jo në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse. Menaxhimi periodikisht vlerëson pozicionet e marra në deklaratat tatimore në lidhje me situatat në të cilat rregulloret e aplikueshme tatimore janë subjekt interpretimi dhe krijon provigjione aty ku është e përshtatshme.

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.6 Tatimi mbi të ardhurat (vazhdim)

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet si diferenca e përkohshme mes vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve në Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe bazës së tatueshme korresponduese përdorur në llogaritjen e fitimit të tatueshëm. Detyrimet e tatimit të shtyrë në përgjithësi llogariten për të gjitha diferencat e tatueshme të përkohshme. Aktivet e tatimit të shtyrë në përgjithësi njihen për të gjitha diferencat e zbritshme të përkohshme në masën që ekziston mundësia që fitimi i tatueshëm do të jetë i mundshëm në mënyrë që këto diferenca të zbritshme të përkohshme të mund të përdoren. Këto aktive dhe detyrime të tatimit të shtyrë nuk do të njihen në qoftë se këto diferenca rezultojnë nga njohja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve në një transaksion që nuk prek as fitimin e tatueshëm, as fitimin kontabël.

Vlera kontabël e aktiveve dhe detyrimeve të tatimit të shtyrë rishikohet në fund të çdo periudhe raportuese dhe reduktohet në masën që nuk është më e mundur që të arrihet një fitim i tatueshëm i mjaftueshëm që të lejojë që një pjesë ose i gjithë aktivi të rikuperohet. Detyrimet dhe aktivet e tatimit të shtyrë maten me normën e tatimit që pritet të përdoret në periudhën në të cilën detyrimi ka ndodhur ose aktivi është realizuar, bazuar në normat e tatimit dhe legjislacionit fiskal që ka qenë në fuqi ose ka hyrë në fuqi në fund të periudhës së raportimit.

2.7 Aktivet afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Manaxhimi gjykon që përdorimi i modelit të koston jep një paraqitje të drejtë të vlerave të aktiveve afatgjata. Shoqëria përcakton jetëgjatësinë e aktiveve bazuar në faktorët e tregut duke iu përshatur sa më shumë kushteve aktuale të të operuarit. Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e aktivitet. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj pajisjeje. Në momentin që një nga aktivitet afatgjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato rregjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivitet afatgjatë material dhe njihen neto në të ardhura ose humbje të tjera.

Kostot në vijim

Shpenzimet e mëvonshme përfshihen në vlerën kontabël të aktivitet ose njihen si një aktiv i veçantë, sipas nevojës, vetëm kur kemi siguri që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin do të rrjedhin në shoqëri dhe kosto e aktivitet mund të matet me besueshmëri. Kostot e riparimeve të vogla dhe mirëmbajtjes ditore njihen si shpenzime në momentin kur ato ndodhin. Kostoja e zëvendësimit të pjesëve të mëdha apo komponentë të aktiveve afatgjata materiale kapitalizohen dhe pjesa e zëvendësuar ç'regjistrohet.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi një bazë lineare mbi jetëgjatësinë e vlerësuar të aktiveve. Normat vjetore të amortizimit për klasat kryesore të aktiveve afatgjata materiale janë si më poshtë:

Përshkrimi	Norma vjetore e amortizimit
Ndërtesa	3%
Makineri e Pajisje	5 -20%
Mjete transporti	13-20%
Mobilje dhe Orendi	20%
Pajisje informatike	25%

Një zë i aktiveve afatgjata materiale ç'regjistrohet kur del jashtë përdorimi apo shitet, ose kur nuk priten përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi ose shitja. Cdo fitim ose humbje që rrjedh nga mosnjohja (ç'regjistrimi) e aktivitet (llogaritur si diferencë mes të ardhurave nga pakësimi dhe vlerës kontabël të aktivitet), paraqitet në të ardhura ose shpenzime kur aktivi ç'regjistrohet. Vlera e mbetur e aktivitet, jeta e dobishme dhe metodat e amortizimit rishikohen cdo periudhë financiare, duke bërë ndryshimet e nevojshme sipas rastit në fund të cdo viti financiar.

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.8 Aktivet jo-materiale

Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata jo-materiale të përfuara veçmas njihen fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare, aktivitet afatgjata jomateriale njihen me koston minus amortizimin e akumuluar, dhe zhvlerësimin e akumuluar, nëse ka

Amortizimi

Aktivitet afatgjata jomateriale me jetë të dobishme të përcaktuar amortizohen përgjatë jetës së tyre të dobishme ekonomike dhe vlerësohen për zhvlerësim sa herë që ka një tregues që aktivitet afatgjatë jomaterial mund të jetë zhvlerësuar. Periudha dhe metoda e amortizimit të aktiveve afatgjata jomateriale me jetë të dobishme të përcaktuar, rishikohet të paktën në çdo datë raportimi.

Jetëgjatësia e dobishme e aktiveve afatgjata jomateriale vlerësohet të jetë e fundme. Amortizimi llogaritet me metodën lineare përgjatë jetës së dobishme ekonomike të vlerësuar të aktiveve afatgjata jomateriale. Norma vjetore e amortizimit të aktiveve afatgjata jomateriale është 10%-25%.

Amortizimi vjetor është paraqitur nën zërin amortizime dhe zhvlerësime në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (shih shënimin Nr. 15)

2.9. Qiratë

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019), përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shënimet shpjeguese të qirasë. Të gjitha qiratë rezultojnë që qiramarrësi merr të drejtën e përdorimit të një aktivitet në fillim të periudhës së qirasë dhe nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës, gjithashtu merr financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirave si qira operative ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilizimeve nga qiramarrësit.

Shoqëria ka njohur:

(a) aktivitet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, pasi nuk ka pasur raste kur aktivitet është me vlerë të ulët; dhe

(b) amortizimin e aktiveve të marra me qira veçmas nga interesi për detyrimet e qirasë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

SNRF 16 mbart të njëjtat kërkesa për kontabilizimin e qirasë nga qiradhënësit si SNK 17, por që tek Shoqëria nuk ka impakt.

Matja fillestare

Matja fillestare e aktivitet me të drejtë përdorimi

Në datën e fillimit, Shoqëria në rolin e qiramarrësit mat aktivitet me të drejtë përdorimi me kosto. Kosto e aktivitet me të drejtë përdorimi do të përfshijë;

a) shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë sic përshkruhet më poshtë;

b) çdo pagesë të qirasë të bërë para ose në datën e fillimit minus çdo stimul qiraje të marre;

c) çdo kosto fillestare të drejtëpërdrejtë të kryer nga qiramarrësi; dhe

d) dhe një vlerësim të kostove që do të ndodhin nga qiramarrësi për cmontimin dhe lëvizjen e aktivitet bazë

Matja fillestare e detyrimit të qirasë

Në datën e fillimit, Shoqëria në rolin e qiramarrësit e mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë, të cilat nuk janë paguar në atë datë. Pagesat e qirasë skontoohen duke përdorur normën e interesit të përcaktuar të qirasë, nëse kjo normë përcaktohet lehtë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtë, qiramarrësi do të përdor normën rritëse të huamarrjes së Shoqërisë.

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.9. Qiratë (vazhdim)

Matja e mëpasshme

Matja e mëpasshme e aktivitetit me të drejtë përdorimi

Pas datës së fillimit, Shoqëria në rolin e qiramarrësit e mat aktivin me të drejtë përdorimi duke përdorur modelin e kostos.

Matja e mëpasshme e detyrimit të qirasë

Matja e mëpasshme e detyrimit të qirasë bëhet si më poshtë:

- a) duke rritur vlerën kontabël (neto) për të reflektuar interesin në detyrimin e qirasë;
- b) duke pakësuar vlerën kontabël (neto) për të reflektuar pagesat e qirasë;
- c) duke rimatur vlerën kontabël (neto) për të reflektuar çdo rivlerësim ose modifikim të qirasë.

2.10 Inventarët

a) Inventar mallra konsumi

Inventarët mallra për rishitje dhe produkte të prodhura përbehet nga profile të lyster dhe të palyer si dhe Termik, por njekohesisht dhe nga aksesore të ndryshme.

Inventari paraqitet me vlerën më të ulët mes koston dhe vlerës neto të realizueshme. Në inventar përfshihen të gjitha shpenzimet të lidhura me blerjen, transportin, tarifatat doganore dhe sigurimin e ngarkesave.

Vlera neto e realizueshme paraqet çmimin përfundimtar të shitjes për inventarët minus të gjitha kostot e vlerësuar të kompletimit dhe shpenzimet e nevojshme për të bërë shitjen.

Gjendjet e inventarëve të Shoqërisë në fund të vitit ushtrimor janë vlerësuar dhe paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me metodën e koston mesatare të ponderuar të kostove të marrjes dhe prodhimit të tyre.

Vlera neto e realizueshme i referohet vlerës neto që njësia ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.

Inventarët i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e mbylljes së pasqyrave financiare. Shuma e zhvlerësimit njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse atëherë kur ka faktorë objektive që tregojnë që inventarët janë zhvlerësuar.

2.11 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Shoqëria vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë indikacion që një aktiv mund të jetë zhvlerësuar. Nëse ekziston ndonjë tregues, ose kur kërkohet testimi vjetor i zhvlerësimit për një aktiv, Shoqëria vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivitetit. Shuma e rikuperueshme e një aktiviteti është vlera më e lartë mes vlerës së drejtë të njësive së gjenerimit të mjeteve monetare minus koston e shitjes dhe vlerës në përdorim të aktivitetit, dhe përcaktohet për një aktiv individual, përveç nëse aktiviteti nuk gjeneron flukse monetare hyrëse që janë kryesisht të pavarura nga flukset monetare hyrëse të aktiveve të tjera ose grupeve të aktiveve të Shoqërisë. Kur vlera kontabël e një aktiviteti ose e njësive së gjenerimit të mjeteve monetare tejkalon shumën vlerës së rikuperueshme, aktiviteti konsiderohet i zhvlerësuar dhe vlera e tij zvogëlohet deri në vlerën e tij të rikuperueshme.

Gjatë përcaktimit të shumës në përdorim, flukset e pritshme monetare skontojnë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë zbritjeje para tatimit që reflekton vlerësimin aktual të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike për këtë aktivitet. Në përcaktimin e vlerës së drejtë minus kostove të transaksionit merren në konsideratë transaksionet më të fundit në treg, nëse janë të disponueshme. Nëse nuk mund të identifikohen transaksione të tilla, përdoret një model i përshtatshëm vlerësimi.

Shoqëria bazon llogaritjen e vlerës së zhvlerësimit në buxhetet e hollësishme dhe llogaritjet e parashikimit të cilat përgatiten veçmas për secilën prej njësive të gjenerimit të mjeteve monetare të Shoqërisë, në të cilat janë alokuar aktivitetet individuale. Këto buxhete dhe parashikimet zakonisht mbulojnë një periudhë prej pesë vitesh. Për periudhën më të gjatë, llogaritjet një normë afatgjatë rritjeje dhe aplikohet në skontimin e flukseve monetare të ardhshme pas vitit të pestë.

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.11 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare (vazhdim)

Humbjet nga zhvlerësimi i operacioneve të vazhdueshme, përfshirë zhvlerësimin në inventarë, njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në ato kategori shpenzimesh në përputhje me funksionin e aktivitetit të zhvlerësuar, përveç pronave të rivlerësuar më parë, ku rivlerësimi ishte marrë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Në këtë rast, zhvlerësimi njihet gjithashtu në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse deri në shumën e ndonjë rivlerësimi të mëparshëm.

Për aktivet pa përjashtim të emrit të mirë, bëhet një vlerësim në secilën datë raportimi nëse ekziston ndonjë tregues që tregon që humbjet nga zhvlerësimi të njohura më parë mund të mos ekzistojnë më ose mund të jenë ulur.

Nëse një tregues i tillë ekziston, Shoqëria vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivitetit ose të njësive të gjenerimit të mjeteve monetare. Humbjet e mëparshme të zhvlerësimit mund të kthehen vetëm nëse ka pasur një ndryshim në supozimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme të aktivitetit që nga njohja e fundit e humbjes nga zhvlerësimi.

Ky kthim është i kufizuar në mënyrë që shuma e mbartur e aktivitetit të mos e kalojë shumën e rikuperueshme të tij, dhe as të tejkalojë shumën e mbartur e cila do të ishte përcaktuar, si amortizim neto, nëse nuk do të njihëj humbje nga zhvlerësimi për aktivin në vitet e mëparshme. Ky kthim njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse përveç nëse aktiviteti mbahet me vlerën e rivlerësuar të aktivitetit, rast në të cilin kthimi trajtohet si një rritje nga rivlerësimi.

Aktivet e mëposhtme kanë karakteristika specifike për testimet e zhvlerësimit:

Aktivet jo-materiale

Aktivet jo-materiale me jetëgjatësi të dobishme të papërcaktuar testohen për zhvlerësim individual ose në nivel njësie të gjenerimit të parasë në çdo periudhë raportimi.

2.12 Instrumentat financiarë

Një instrument financiar është cdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një Shoqërie dhe një detyrim financiar ose instrumenta të kapitalit për një Shoqëri tjetër.

i) Aktivet financiare

Njohja dhe matja fillestare

Aktivet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes.

Klasifikimi i aktiveve financiare në njohjen fillestare varet nga karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitetit financiar dhe nga modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e tyre.

Në mënyrë që një aktiv financiar të klasifikohet dhe të matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, është e nevojshme të sjellë flukse të mjeteve monetare të cilat janë 'vetëm pagesa e principalit dhe interesit (VPPI)' mbi principalin e mbetur. Ky vlerësim quhet si testi VPPI dhe aplikohet në nivel instrumenti financiar.

Modeli i biznesit i Shoqërisë për menaxhimin e aktiveve financiare i referohet mënyrës se si Shoqëria menaxhon aktivet e saj financiare në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare. Modeli i biznesit përcakton nëse flukset monetare sigurohen si rezultat i arkëtimit të flukseve monetare kontraktuale, shitja e aktiveve financiare ose si rrjedhojë e të djave së bashku.

Matja e mëtejshme

Për qëllime të matjes së mëtejshme, aktivet financiare klasifikohen në katër kategori:

- Aktivet financiare me koston e amortizuar (instrumentet e borxhit);

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.1.2 Instrumentat financiarë (vazhdim)

- Aktivet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse me qarkullim të fitimeve dhe humbjeve kumulative (instrumentat e borxhit);
- Aktivet financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse pa qarkullim të fitimeve dhe humbjeve kumulative në momentin e heqjes nga librat kontabël (instrumentat e kapitalit);
- Aktivet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Alumil Albania ka aktive financiare vetëm të kategorisë së parë, e cila përshkruhet më me detaje më poshtë.

Aktivitet financiarë me koston e amortizuar (instrumentat e borxhit)

Kjo kategori është e vetmja e aplikueshme për Shoqërinë. Alumil Albania mat aktivet financiare me koston e amortizuar nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- aktivi financiar mbahet brenda një modeli biznesi me qëllim të mbajtjes së mjeteve financiare për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe
- kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar të japin rritje në data të përcaktuara flukse monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar.

Aktivitet financiarë me kosto të amortizuar maten duke përdorur metodën e interesit efektiv (nese ka interes) dhe janë subjekt i zhvlerësimit. Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktivi çregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet.

Aktivitet financiarë të Shoqërisë që maten me koston e amortizuar përbëhen kryesisht nga të drejta të arkëtueshme dhe paratë dhe ekuivalentët e saj.

Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar (ose, aty ku është e mundur, një pjesë të një aktiviteti financiar ose një pjesë të një grupi të aktiveve financiare të ngjashme) fillimisht çregjistrohet (hiqet nga pasqyra e pozicionit financiar të Shoqërisë) kur:

- të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar kanë përfunduar
- transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit pjesa më e madhe e rreziqeve dhe e përfitimeve të pronësisë së aktivitetit financiar, janë transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivitetit financiar.

Shoqëria mund të bëhet pjesë e transaksioneve me anë të të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar por ruan pjesën më të madhe ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në të tilla raste, aktivet e transferuara nuk çregjistrohen.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Shoqëria njeht një fond për humbjet e pritshme për të gjitha instrumentat e borxhit të cilat nuk mbahen me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Humbjet e pritshme përlllogariten si diferencë midis flukseve monetare kontraktuale të pritshme sipas kontratës me flukset monetare që Shoqëria pret të marrë, të diskontuara përfaqësisht me normën efektive fillestare të interesit. Flukset e pritshme monetare do të përfshijnë flukset e mjeteve monetare nga shitja e kolateralit të mbajtur ose përmirësimet e tjera të kredisë që janë pjesë përbërëse e kushteve kontraktuale.

Për të drejtat e arkëtueshme, dhe aktivet e kontratës, Shoqëria përdor metodën e thjeshtëzuar në llogaritjen e humbjeve të pritshme. Si rrjedhim, Shoqëria nuk ruan ndryshimet në riskun e kredisë, por përlllogarit një provigjon për llogari të dyshimta bazuar mbi humbjet e pritshme të përjetshme në çdo datë raportimi.

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.12 Instrumentat financiarë (vazhdim)

i) Aktivet financiare (vazhdim)

Shoqëria ka krijuar një matricë provigjoni e cila bazohet në përvojën e saj historike të humbjeve e përshtatur për faktorët e ardhshëm që janë specifikë për klientët dhe mjedisin ekonomik në të cilën ata operojnë. Gjithashtu Shoqëria në analizën e saj merr parasysh dhe marrdhënien e klientëve që janë njëkohësisht dhe furnitorë, për të cilët nuk kryhet pagesa për furnizime deri në masën e detyrimit që ata kanë kundrejt Alumil Albania si klient.

Shoqëria konsideron një aktiv financiar në vështirësi për t'u arkëtuar kur pagesat kontraktuale janë 90 ditë me vonesë. Megjithatë, në raste të caktuara, Shoqëria mund të konsiderojë gjithashtu një aktiv financiar me vonesë pagese, kur informacioni i brendshëm ose i jashtëm tregojnë se Shoqëria nuk ka gjasa të marrë shumat e papaguara kontraktuale në tërësi përpara se të marrë parasysh çdo përmirësim të riskut të kredisë. Një aktiv financiar hiqet nga librat kontabël kur nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rikuperimin e flukseve monetare kontraktuale.

ii) Detyrimet financiare

Njohja fillestare dhe matja

Detyrimet financiare, në njohjen fillestare, klasifikohen si: detyrime financiare nëpërmjet pasqyrës së fitimeve dhe humbjeve, kredi dhe borxhe, llogari të pagueshme, ose si derivate të destinuara si instrumenta mbrojtës në një mbrojtje efektive, sipas përkatësisë. Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe, në rastin e kredive dhe borxheve dhe llogarive të pagueshme, njihen neto me kostot direkte të transaksionit.

Detyrimet financiare të Alumil Albania përfshijnë llogaritë e pagueshme, kreditë bankare dhe hua të tjera.

Matja e mëtejshme

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre, siç përshkruhet më poshtë:

- detyrimet financiare me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së fitimit ose humbjes
- kredi bankare dhe hua të tjera

Shoqëria nuk ka detyrime financiare të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit dhe humbjes, dhe me poshtë paraqitet një përmbledhje e kredive dhe borxheve:

Kreditë dhe borxhet

Pas njohjes fillestare, kreditë dhe borxhet maten më tej me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet njihen në pasqyrën e fitimeve dhe humbjeve në momentin kur detyrimet hiqen nga librat kontabël si dhe nëpërmjet procesit të amortizimit me interesin efektiv.

Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë në konsideratë cdo ulje të përfituar në blerje si dhe tarifata ose kostot që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Amortizimi me normën efektive të interesit njihet si kosto financiare në pasqyrën e fitimeve dhe të humbjeve.

Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shlyhen, anulohen ose shuhen. Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe rrjedhimisht flukset monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet një detyrim financiar i ri, me vlerën e drejtë, i bazuar në kushtet e modifikuara.

Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca mes vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë cdo aktiv jomonetar të transferuar apo detyrime të supozuara) njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.13 Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe pensionet

Shoqëria, në rrjedhën normale të aktivitetit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin vendas. Kostot e paguara nga Shoqëria regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse të të ardhurave (fitim ose humbje) kur ndodhin.

2.14 Provigjonet

Të përgjithshme

Provigjoni njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, Shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vërtetësi, dhe ka mundësi që të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parasë për të shlyer këtë detyrim. Provigjonet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

Provizione për çështje gjyqësore

Shoqëria është në proces gjyqësor me disa prej klienteve të saj, dhe për këtë arsye ka ngritur provigjionet perkatese në pasqyrat e saj financiare.

2.15 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Shpenzimet financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare.

Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto. Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

2.16 Përcaktimi i vlerës së drejtë

Një numër i politikave kontabël të shoqërisë dhe shënimeve shpjeguese kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo-financiare. Drejtimi i Shoqërisë vlerësoi se vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalentët të tyre, llogarive të arkëtueshme tregtare, llogaritë e pagueshme tregtare, aktivet dhe detyrimet e tjera afatshkurtra përafrojnë vlerën e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimeve afatshkurtra të këtyre instrumenteve.

2.17 Standarde dhe interpretime të reja, ende të paadoptuara

Një numër i standardeve të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime nuk janë ende të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021 dhe nuk janë zbatuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Shoqëria planifikon të zbatojë këto ndryshime kur të hyjnë në fuqi.

- Shitja ose Kontributi i Aktiveve midis një Investitori dhe Shoqërisë ose Sipërmarrjes së Përbashkët të tij -Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (të publikuara më 11 shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas një date që do të përcaktohet nga BSNK).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (publikuar më 18 maj 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023).
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata-Ndryshime në SNK 1 (publikuar në 23 janar 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).
- Kontrata me kushte renduese-Kostot e permbushjes së një kontrate, Referenca ndaj Kuadrit Konceptual-Ndryshime në SNK 16, SNK 37 dhe SNRF (publikuar në 14 maj 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).
- Klasifikimi i detyrimeve si rrjedhëse ose afatgjata, shtyrja e datës së hyrjes në fuqi – Ndryshimet në SNK 1 (publikuar më 15 korrik 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023);
- Ndryshimet në SNRF 17 dhe një ndryshim në SNRF 4 (publikuar më 25 qershor 2020 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023);

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.17 Standarde dhe interpretime të reja, ende të paadoptuara (vazhdim)

- Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës 2 SNRF: Dhënia e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël (publikuar më 12 shkurt 2021 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023);
- Ndryshime në SNK 8: Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (lëshuar më 12 shkurt 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023)
- Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm – Ndryshimet në SNK 12 (publikuar më 7 maj 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023).
- Opsioni i tranzicionit për siguresit që zbatojnë SNRF 17 – Ndryshimet në SNRF 17 (publikuar më 9 dhjetor 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023)

3. GJYKIME TË RËNDËSISHME KONTABËL, VLERËSIME DHE SUPOZIME

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me IFRS kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në mënyrë prospektive.

Informacioni mbi supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të rezultuar në një rregullim material të vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit që përfundon më 31 dhjetor 2022 është dhënë më poshtë:

(i) Njohja e aktivitetit të tatimit të shtyrë

Aktivitetit të shtyrë të njohura përfaqësojnë tatimin mbi fitimin që mund të rikuperohet përmes zbritjeve të ardhshme nga fitimet e tatueshme, kryesisht të lidhura me diferencat midis amortizimit kontabël dhe fiskal të aktiveve afatgjata materiale, duke rezultuar në bazën tatimore të këtyre aktiveve më të larta se vlerat përkatëse të tyre kontabël. Aktivitetit të shtyrë njihen në atë masë që është e mundur që do të ketë fitime të tatueshme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren.

(ii) Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale

Drejtimi beson se Shoqëria do të vazhdojë të jetë fitimprurëse në të ardhmen bazuar në linjat e prodhimit që janë të mjaftueshme për të gjeneruar fitime dhe flukse monetare operative pozitive. Vlerësimi i vlerave të aktiveve afatgjata është çështje e gjykimit bazuar në përvojën, kushtet aktuale dhe pritshmëritë për të ardhmen me aktive të ngjashme.

Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata materiale

Vlerësimi i jetës së dobishme të zërave të aktiveve afatgjata materiale është çështje e gjykimit bazuar në përvojën me aktive të ngjashme. Përfitimet ekonomike të ardhshme të mishëruara në aktive konsumohen kryesisht përmes përdorimit. Megjithatë, faktorë të tjerë, siç janë vjetërsia teknike dhe tregtare dhe konsumimi, shpesh rezultojnë në zvogëlimin e përfitimeve ekonomike të aktiveve. Drejtimi vlerëson jetët e dobishme të mbetura në përputhje me kushtet aktuale teknike të aktiveve dhe periudhën e vlerësuar gjatë së cilës pritet që aktivitetit të gjenerojnë përfitime për Shoqërinë.

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT E MENAXHIMIT TË RISKUT FINANCIAR

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme në lidhje me instrumentet e veta financiare. Rreziqet kryesore të mundshme janë rreziku i tregut, rreziku i kredisë dhe rreziku i likuiditetit.

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që vlera e drejtë e flukseve të ardhshme monetare nga instrumentet financiare do të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në cmimet e tregut. Cmimet e tregut përfshijnë tre lloje rreziqesh: rreziku i normës së interesit, rreziku i kursit të këmbimit dhe rreziku i cmimeve të tjera, si për shembull rreziku i ndryshimit të cmimeve të letrave me vlerë të tregtuara në bursë. Instrumentet financiare të ndikuara nga rreziku i tregut përfshijnë kreditë dhe llogaritë e pagueshme.

Analizat e ndjeshmërisë në seksionet e mëposhtme lidhen me pozicionin më 31 dhjetor 2021. Analizat e ndjeshmërisë janë përgatitur sipas supozimit se shumica e borxhit dhe pjesa e instrumenteve financiare në monedhë të huaj janë konstante. Analiza përjashton ndikimin e ndryshimeve të variablave të tregut të provigjoneve.

Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku se vlera e drejtë e flukseve të ardhshme monetare nga instrumentet financiare do të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në normën e interesit të tregut. Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të ndryshimit të normave të interesit të tregut lidhet me detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata të Shoqërisë me norma të ndryshueshme. Meqë këto kredi janë kryesisht afatshkurtra, Shoqëria nuk e konsideron rrezikun të rëndësishëm dhe nuk ka adoptuar ende ndonjë politikë për ta zvogëluar atë. Tabela e mëposhtme tregon ndjeshmërinë ndaj ndryshimeve të mundshme dhe të arsyeshme të normës së interesit, me të gjitha variablat e tjera të mbajtura konstante, në fitimin e Shoqërisë para tatimit (përmes ndikimit të normave të ndryshueshme të kredisë).

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Rritje prej 100 Pike Baze	1,099	604
Në % të fitimit para tatimit	0.92%	0.31%

Rreziku i kursit të këmbimit

Rreziku i kursit të këmbimit është rreziku që vlera e drejtë e flukseve të ardhshme monetare nga instrumentet financiare do të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit. Shoqëria hyn në transaksione me valutë të huaj lidhur me aktivitetin e saj financiar dhe operativ. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument financiar specifik për t'u mbrojtur nga rreziku. Pjesa më e madhe e transaksioneve të Shoqërisë janë në euro dhe lekë dhe meqenëse kursi i këmbimit Lekë/Euro është i qëndrueshëm, rreziku i kursit të këmbimit konsiderohet të jetë i ulët.

31 dhjetor 2022	EUR	USD	LEK	Totali
Aktive financiare				
Mjete monetare	98,118,998	-	33,634,700	131,753,698
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	117,704,717	-	1,658,860	119,363,577
	215,823,715	-	35,293,560	251,117,275
Detyrime financiare				
Furnitorë dhe detyrime të tjera	25,846,270	-	15,238,036	41,084,306
Hua	109,873,730	-	-	109,873,730
	135,720,000	-	15,238,036	150,958,036
Hendeku i monedhës më 31 dhjetor 2022	80,103,715	-	20,055,524	100,159,239

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT E MENAXHIMIT TË RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

31 dhjetor 2021	EUR	USD	LEK	Totali
Aktive financiare				
Mjete monetare	95,952,367	-	18,449,142	114,401,509
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	184,713,152	-	32,578,825	217,291,977
	280,665,519	-	51,027,967	331,693,486
Detyrime financiare				
Furnitorë dhe detyrime të tjera	85,546,408	-	19,009,957	104,556,365
Hua	60,380,000	-	-	60,380,000
	145,926,408	-	19,009,957	164,936,365
Hendeku i monedhës më 31 dhjetor 2021	134,739,111	-	32,018,010	166,757,121

Rreziku i kreditimit

Rreziku i kreditimit lind në rastin kur nuk arrin të përmbushë detyrimet në rastin e një instrumenti financiar. Shoqëria është e ekspozuar kundrejt një rreziku të rëndësishëm të kreditit duke qenë se ka relativisht nivel të lartë të llogarive të arkëtueshme nga klientët. Për shkak të karakteristikave të biznesit të saj, Shoqëria shet mallra të një numri të madh klientesg ku cmimi i shitjes paguhet me para në dorë ose me terma pagese te mevonshme. Transaksionet monetare kryhen nëpërmjet institucioneve që kanë vlerësim të mirë kreditor.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë:

Vlera e mbartur e aktiveve financiare paraqet maksimumin e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë. Maksimumi i ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë më 31 dhjetor 2021 është paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Llogari të arkëtueshme dhe të drejta të tjera, bruto	206,480,590	237,403,500
Mjete monetare dhe ekuivalentët e saj (pa përfshirë para në dorë)	109,687,355	112,749,564
Totali	316,167,945	350,153,064

Rreziku i likuiditetit

Menaxhimi efektiv i likuiditetit të Shoqërisë lidhet me sigurimin e financimit të kapitalit qarkullues përmes përdorimit të kredive me interes nga palët e lidhura dhe bankat. Drejtuesit e Shoqërisë vazhdimisht monitorojnë afatin dhe kryerjen e pagesave në kohë duke mbajtur të përditësuar informacionin mbi flukset e nevojshme të parasë dhe pagesat e ardhshme. Paratë e disponueshme investohen në depozita afatshkurtra me norma interesi me të mira në bankat vendase.

Më 31 dhjetor, struktura e maturitetit të detyrimeve financiare të Shoqërisë ndaj pagesave kontraktuale të paskontuara paraqitet si më poshtë:

	< 3 muaj	3 - 12 muaj	1 - 5 vjet	Totali
31 dhjetor 2022				
Hua me interes	-	109,873,730	-	109,873,730
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	33,636,941	7,447,365	-	41,084,306
Totali	33,636,941	117,321,095	-	150,958,036
31 dhjetor 2021				
Hua me interes	-	60,380,000	-	60,380,000
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	93,213,851	11,342,514	-	104,556,365
Totali	93,213,851	71,722,514	-	164,936,365

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

5. TË ARDHURA NGA KONTRATAT ME KLIENTËT

Të ardhura nga kontratat me klientët për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shitje e Produkteve te Gatshem	2,670,277,026	2,140,358,020
Shitje e mallrave	506,995,654	462,826,784
Shitje e nenprodukteve	129,361,144	81,997,597
Shitje e materialeve te para	17,439,181	6,869,749
Totali	3,324,073,005	2,692,052,150

- (a) Shitje të produkteve të gatshme permbajne profilet dhe aksesoret e prodhuar.
- (b) Shitje e mallrave permban materialet e blera nga ana e Shoqerise me qellim rishitjen e tyre
- (c) Shitja e materialeve te para permban materialet te cilat jane perdorur kryesisht per perdorime te brendshme te shoqerise
- (d) Shitje e nenprodukteve permban shitjen e Skrapit te krijuar si pjese e procesit teknologjik te prodhimit

Të ardhura nga kontratat me klientët për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Te Ardhura nga Lyerja	7,650,693	6,260,365
Te ardhura nga transporti	6,227,935	70,635
Te Ardhura nga sherbimi (perpunimi)	-	41,771
Totali	13,878,628	6,372,771

6. TË ARDHURA TË TJERA

Të ardhura të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Te ardhura nga reduktimi I qerese financiare	24,654,007	-
Rimarrje nga Provigjionet	4,875,767	5,893,176
Te ardhura nga shitja e asetëve	3,315,976	-
Te Ardhura nga Siguracionet	1,207,004	5,331,782
Te ardhura te tjera CN	(3,298,691)	-
Te Ardhura nga Qerate	-	96,000
Totali	30,754,063	11,320,958

- (a) Te Ardhura nga Kredit Note permbajne te ardhurat e perfituara nga ana e furnitoreve si pasoje e zbritjeve te ndryshme te kryer nga ana e tyre
- (b) Te Ardhura nga Qerate permbajne te ardhurat qe Shoqeria perfiton nga dhënia me qera te disa prej ambjenteve te saj
- (c) Rimarrje nga Provigjionet permbajne rimarrjen e provigjioneve te ngritura nga debitoret me risk te larte dhe inventarit te vjeteruar

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

7. KOSTO E MALLRAVE TE SHITUR

Kosto e mallrave të shitur për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Ndryshim I Gjendjes se Inventarit	36,937,453	215,806,238
Kostot e shitjeve	(2,453,108,638)	(2,004,799,950)
Totali	(2,416,171,185)	(1,788,993,712)

8. SHPENZIME PER MATERIALE

Shpenzimet për materialet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Blerje Energji Elektrike	54,695,325	37,363,700
Blerje Naftë dhe Benzine	13,348,754	8,631,652
Shpenzime Materiale Publicitare	4,189,235	1,911,384
Blerje te tjera	1,221,401	2,761,377
Blerje te pastokushme	504,721	1,350,951
Totali	73,959,436	52,019,064

Shoqëria ka pasur rritje të shpenzimeve për blerje të energjisë elektrike dhe lëndëve djeshë si nafta dhe benzina. Pozicionimi sa më i mirë në treg, ka bërë që shoqëria të rrisë shpenzimet për materialet e produkteve të ekspozuara për klientët. Përsa i përket shpenzimeve të tjera, karahasuar me vitin paraardhës kemi ulje të shpenzimeve.

9. SHPENZIME PER SHERBIME

Shpenzime për shërbime për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shpenzime Konsultimi dhe Certifikimi	78,348,246	81,025,931
Sherbime nga te Tretet	27,347,361	24,303,841
Shpenzime marketing	23,806,724	36,104,006
Shpenzime mirmbajtje dhe riparime	23,630,915	16,408,852
Shpenzim Transporti	17,857,842	14,551,184
Shpenzime per siguracione	3,139,555	4,206,888
Shpenzime internet dhe cellular	2,576,840	3,053,909
Shpenzime Bankare	1,723,592	3,188,427
Shpenzime Qera Operacionale	1,615,118	14,816,953
Shpenzime per uje	1,367,120	1,470,007
Shpenzime per Leje mjedisore	1,312,475	1,382,468
Totali	182,725,788	200,512,466

Shoqëria ka pasur rritje relativisht të lartë të shpenzimeve për blerje nga të tretët, shpenzimeve për mirëmbajtje dhe riparime si dhe shpenzimet për transport. Vlen të theksohet ulja e disa zërave të shpenzimeve si shpenzimet për marketing, shpenzimet për konsultime dhe certifikime si dhe shpenzimet për qera operacionale. Këto të fundit janë ulur për shkak të riklasifikimit të qerave sipas Standardit SNRF 16 për Qeratë.

Shoqëria krahasuar me vitin 2021 ka rritje të ndjeshme të shpenzimeve referuar dhe periudhës së Pandemisë COVID 19 e cila solli si pasojë reduktim të të ardhurave por njëkohësisht dhe të shpenzimeve të saj, në mënyrë që të kishte mbikqyrje të vazhdueshme të performancës së saj në treg.

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

10. SHPENZIME PER PAGA DHE DETYRIME

Shpenzimet për paga dhe detyrime për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>
Pagat e punonjësve	320,996,024	292,021,656
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	36,662,019	33,935,592
Shpenzime per Siguracion Jete	2,489,828	2,975,139
Shpenzime te tjera per punonjesit	394,539	-
Totali	360,542,410	328,932,387

11. SHPENZIME TE TJERA

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>
Shpenzime per Provigjione	8,105,212	4,354,790
Shpenzime per pritje	7,881,497	3,663,526
Shpenzime per taksa dhe tatime	5,215,364	3,990,508
Shpenzime per Dieta dhe Udhetime	3,201,512	1,708,499
Shpenzime per Dhurata	3,078,449	988,176
Shpenzime per Gjoha	1,103,963	187,487
Sponsorizime te ndryshme	1,001,903	551,548
Shpenzime per fatkeqesi familjare	671,268	-
Shpenzime te Tjera	246,996	-
Vlera Neto e Aktiveve te Shitura	-	564,079
Totali	30,506,164	16,008,613

12. FITIMI/(HUMBJA) NGA KËMBIMET VALUTORE, NETO

Fitimi/(humbja) nga këmbimet valutore, neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>
Fitimi nga këmbimet valutore	97,191,770	24,498,821
Fitimi nga këmbimet valutore snrf 16	-	-
Humbja nga këmbimet valutore	(83,944,064)	(17,604,104)
Totali	13,247,706	6,894,717

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

13. TË ARDHURA/(SHPENZIME) FINANCIARE, NETO

Të ardhurat/(shpenzimet) financiare, neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shpenzime per Interesa Overdrafti	14,774,651	1,911,202
Shpenzime per Interesa snrf 16	3,531,065	-
Te Ardhura nga Interesat	(72)	-
Totali	18,305,644	1,911,202

Aktulisht Shoqëria ka një listë financimesh si më poshtë të mundësuar nga tre institucione bankare në vend:
Overdraft - Shoqëria ka pasur një linjë Overdrafti tek Raiffeisen Bank në vlerën 500,000 Euro për të cilën paguante 3.2% interes vjetor mbi shumën e përdorur. Kjo marrëveshje është rinovuar ne 5 dhjetor 2022 me afat deri në 1 qershor 2024.

Overdraft - Shoqëria ka marrë një Overdraft tek Raiffeisen Bank në vlerën 2,000,000 Euro në datën 10 qershor 2022 me afat kohor deri më 10 qershor 2023.

Overdraft - Shoqëria ka një linjë Overdrafti Overdraft Pro Credit bank në shumën 500,000 Eur me afat kohor deri në 28 Shkurt 2023.

Overdraft - Shoqëria ka një linjë Overdrafti tek Pro Credit bank në shumën 1.135.000 Eur me Nr.05003358 e cila është marrë në 22 gusht 2022 dhe është efektive deri në 28 shkurt 2023.

14. TATIM KORRENT MBI FITIMIN

Rakordimi i shpenzimeve të tatimit mbi të ardhurat llogaritur me normën e tatimit ligjor mbi fitimin nga aktivitetet operative të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Fitimi para tatimit	119,786,107	195,715,679
Të ardhura të patatueshme Rimarrje Provigjioni	(28,265,130)	(5,893,176)
Fitimi i tatueshem	91,520,977	189,822,503
<i>Shtesat:</i>		
Provizione		4,354,512
Shpenzimet e pazbritshme për efekt tatimor	51,060,420	10,075,639
Amortizimi për efekt tatimor	32,827,545	29,200,661
Shpenzimet e pazbritshme për efekt tatimor	83,887,965	43,630,812
Fitimi i tatueshëm	175,408,942	233,453,316
Tatimi mbi fitimin me 15%	26,525,653	34,659,617

Shpenzimet e pazbritshme për efekt tatimor përmbajnë kryesisht qerane e shtepise qe shoqeria paguan per Administratorin, provigjionin e perllogaritur per klientet e keqinj, shpenzimet per pritje dhe percjellje si dhe shpenzimet e ndryshme te kryera per stafin e saj. Gjithashtu përfshihet dhe efekti i amortizimit të aktiveve me të drejtë përdorimi etj.

*(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***15. SHPENZIME NGA TATIM FITIMI I SHTYRE**

Tatimet e shtyra, për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>Per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>
Amortizimi i aktiveve sipas politikës kontabël	93,910,210	105,758,740
Amortizimi i aktiveve me baze të tatueshme sipas tatimeve	61,082,665	76,558,079
Diferenca	32,827,545	29,200,661
Shkalla e tatim fitimit	15%	15%
Tatim i shtyrë	<u>4,924,132</u>	<u>4,380,099</u>
	<u>Per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>
Gjendje më 1 janar	18,315,267	22,695,367
Pakesime ose rritje gjatë vitit	(4,924,132)	(4,380,099)
Gjendja më 31 dhjetor	<u>13,391,135</u>	<u>18,315,267</u>

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

16. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Aktive afatgjata materiale më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

Kosto	Truall	Ndertesa dhe Instalime	Makineri	Mjete Transporti	Mobilije dhe Pajisje Informatike	Punime ne Proses	Total
Më 31 dhjetor 2021	220,489,644	1,135,740,619	1,229,531,142	42,272,504	128,566,456	1,856,103	2,758,456,468
Shtesa	-	2,360,837	25,089,093	-	18,594,044	8,076,129	54,120,103
Pakësime	-	-	-	(14,683,408)	-	(9,693,994)	(24,377,402)
Totali më 31 dhjetor 2022	220,489,644	1,138,101,456	1,254,620,235	27,589,096	147,160,500	238,238	2,788,199,169
Amortizimi							
Më 31 dhjetor 2021	-	526,088,685	952,466,020	36,149,058	103,068,256	-	1,617,772,019
Shtesa	-	37,302,293	66,256,034	1,374,626	12,326,544	-	117,259,497
Pakësime	-	-	-	(12,740,256)	-	-	(12,740,256)
Më 31 dhjetor 2022	-	563,390,978	1,018,722,054	24,783,428	115,394,800	-	1,722,291,260
Vlera kontabël neto							
Totali më 31 dhjetor 2021	220,489,644	609,651,934	277,065,122	6,123,446	25,498,200	1,856,103	1,140,684,449
Totali më 31 dhjetor 2022	220,489,644	574,710,478	235,898,181	2,805,668	31,765,700	238,238	1,065,907,909

Alumil Albania Sh.p.k.
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

17. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE

Aktive afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

Kosto	Programe kompjuterike	Licensa	Totali
Më 31 dhjetor 2021	3,678,529	236,579	3,915,108
Shtesa	17,596	1,031,317	1,048,913
Pakësime	(3,442,842)	-	(3,442,842)
Totali më 31 dhjetor 2022	253,283	1,267,896	1,521,179
Amortizimi			
Më 31 dhjetor 2021	2,944,835	29,815	2,974,650
Shtesa	195,005	180,220	375,225
Pakësime	(2,886,558)	-	(2,886,558)
Më 31 dhjetor 2022	253,282	210,035	463,317
Vlera kontabël			
Totali më 31 dhjetor 2021	733,694	206,764	940,458
Totali më 31 dhjetor 2022	-	1,057,861	1,057,862

18. E DREJTA E PERDORIMIT

E drejta e perdorimit më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

Kosto	Ndertesa	Makineri dhe pajisje pune	Mjete Transporti	Total
Më 31 dhjetor 2021	-	-	-	-
Shtesa	40,282,439	550,886	41,179,106	82,012,431
Pakësime	(24,539,999)	(29,789)	(595,232)	(25,165,020)
Totali më 31 dhjetor 2022	15,742,440	521,097	40,583,874	56,847,411
Amortizimi				
Më 31 dhjetor 2021	-	-	-	-
Shtesa	17,412,327	439,073	17,289,375	35,140,775
Pakësime	(13,987,731)	(22,195)	(731,208)	(14,741,134)
Më 31 dhjetor 2022	3,424,596	416,878	16,558,167	20,399,641
Vlera kontabël neto				
Totali më 31 dhjetor 2021	-	-	-	-
Totali më 31 dhjetor 2022	12,317,844	104,219	24,025,707	36,447,770

Alumil Albania Sh.p.k.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***19. AKTIVE AFATGJATA FINANCIARE**

Aktivet afatgjata financiare më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Parapagime te tjera afatgjate per Qera Makinash	2,720,136	2,394,526
Parapagime te tjera afatgjate per Qera Ndertesash	314,516	225,942
Totali	<u>3,034,652</u>	<u>2,620,468</u>

20. INVENTARE

Inventari i kompanise më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Produkte te Gatshme	476,233,458	439,802,654
Lende te para, te konsumueshme, pjese nderrimi	313,035,436	182,501,430
Mallra per rishitje	148,712,969	144,578,248
Nenprodukte dhe mbeturina.	4,314,051	13,634,466
Prodhime ne Proces	2,163,796	1,657,148
Provigjon për inventarin e vjetruar	(28,167,212)	(23,174,749)
Totali	<u>916,292,498</u>	<u>758,999,197</u>

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Vlera kontabël më 1 janar	23,174,749	29,067,925
Fshirje inventari	4,992,463	(5,893,176)
Provigjon për inventarin e vjetruar – Produkt i Gatshëm	-	-
Totali	<u>28,167,212</u>	<u>23,174,749</u>

Gjatë vitit njësia ka njohur provigjon për inventarin e vjetëruar të cilin e ka përlogaritur me çmim mesatar sipas Bursës London Metal Exchange(LME). Këtë çmim shoqëria e ka përdorur vetëm në vlerësimin e profileve të vjetëruara.

21. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogaria të arkëtueshme më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Te Arketueshme (Kliente Jo Grupi)	93,332,175	140,712,650
Te Arketueshme (Kliente Grupi)	26,031,402	76,579,327
Zhvleresim I Te Drejtave (Kliente Jo Grupi)	(15,190,452)	(30,027,019)
Totali	<u>104,173,125</u>	<u>187,264,958</u>

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Vlera kontabël më 1 janar	30,027,019	29,614,595
Shtesa gjate vitit	(14,836,567)	4,374,053
Pakesime gjate vitit	-	(3,961,629)
Totali	<u>15,190,452</u>	<u>30,027,019</u>

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

21. LLOGARI TË ARKËTUESHME (VAZHDIM)

Shoqëria zbaton SNRF 9 për të matur humbjet e pritshme të kredisë që përdor një shume të humbjes së pritshme të kredisë përgjatë gjithë jetës së aktivitetit, për të gjitha të arkëtueshmet tregtare.

Shkalla e pritshme e humbjeve bazohet në profilet e pagesave të shitjeve për një periudhë prej tre vjetësh përpara datës 1 janar 2022 dhe humbjet historike përkatëse të kredisë të ndodhura brenda kësaj periudhe. Normat historike të humbjeve janë përshtatur për të pasqyruar informacionin aktual dhe të ardhshëm të faktorëve makroekonomikë që ndikojnë në aftësinë e klientëve për të shlyer llogaritë e arkëtueshme

Vlera e humbjes së kredisë për llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera përcaktohet sipas matricës së parashikuar sipas standardit SNRF 9. Matrica e provizionimit bazohet në numrin e ditëve që një aktivi i ka kaluar afati i shlyerjes dhe normat e humbjeve llogariten siç përshkruhet si më poshtë:

	Aktuale	1-30 ditë	31-60 ditë	61-90 ditë	Më shumë se 90 ditë
Norma e skontimit	0.30%	1.60%	3.60%	6.60%	10.60%

22. LLOGARI TE TJERA TE ARKETUESHME

Llogarite e tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Parapagime të dhena	52,299,556	2,607,022
Shpenzime të periudhave të ardhshme	15,406,765	7,297,160
TVSH e Rimbursueshme	11,830,057	8,626,648
Parapagime për Tatimin mbi Fitimin	4,986,448	-
Te Drejta ndaj Doganes	2,438,140	1,524,193
Paradhenie për punonjesit	156,047	56,500
Totali	<u>87,117,013</u>	<u>20,111,523</u>

23. MJETE MONETARE DHE EKUIVLENTE TE TYRE

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Mjete monetare në bankë në EUR	96,925,183	94,984,434
Mjete në tranzit	20,561,400	-
Mjete monetare në bankë në LEK	12,762,172	17,765,130
Arka EUR	1,193,815	967,933
Arka LEK	311,128	684,012
Totali	<u>131,753,698</u>	<u>114,401,509</u>

Alumil Albania Sh.p.k.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***24. KAPITALI AKSIONAR**

Më 31 Dhjetor 2022 shoqëria zotëron një kapital prej 1,481,601,000 lekë në para e cila paraqitet si me poshte :

PERBERJA E KAPITALIT AKSIONAR	Vlere Kapitali	% Kapitali
1 ALUMIL GROUP LTD	1,470,222,000	99.23%
2 Georgios Salpingidis	4,564,500	0.31%
3 Ioannis Boulios	2.148.000	0.15%
4 Sotirios Bulios	2.236.500	0.15%
5 Georgios Mylonas	810,000	0.05%
6 Evangelia Mylonas	810,000	0.05%
7 Majlinda Kalludhi me dy femijet e saj Enea dhe Dhimitra Kalludhi	810,000	0.05%
Total	1,481,601,000	100.00%

Gjate vitit 2022 Shoqëria nuk ka kryer veprime financiare me Kapitalin e saj per pakesime apo rritje te tij.

25. REZERVA STATUORE

Rezervat Statutore të tyre më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Rezerva	16,309,452	16,309,452
Totali	16,309,452	16,309,452

26. DETYRIM PER QIRAMARRJEN FINANCIARE

Detyrim per qiramarrjen financiare më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Afatgjate	24,004,794	-
Afatshkurter	13,144,381	-
Vlera kontabël më 31 Dhjetor	37,149,175	-

Shoqëria ka përdorur Standardin SNRF 16 për përlogaritjen e detyrimit për zërin "E drejta e përdorimit të aktiveve". Në përlogaritjen e detyrimit për qeratë janë përdorur normat e grupit, përkatësisht normat sipas EURIBOR + 3% normë fikse. Politika e grupit Alumil S.A konfirmon se kompanitë e grupit Alumil S.A duhet të përdorin normat e grupit kur normat aktuale nuk mund të përcaktohen saktë nga shoqëritë bija.

27. LLOGARI TË PAGUESHME

Llogari të pagueshme më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Detyrime kundrejt Furnitoreve Jo Grup	32,160,909	22,382,387
Detyrime kundrejt Furnitoreve Grupi	8,923,397	82,173,978
Totali	41,084,306	104,556,365

Llogaritë të pagueshme nuk mbartin interes dhe në përgjithësi janë të pagueshme brenda harkut kohor 60-180 ditë. Detyrimet ndaj furnitorëve të mallrave shlyhen në bazë të faturimit.

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

28. LLOGARI TE TJERA TE PAGUESHME

Llogari e tjera të pagueshme më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Parapagime te marra	15,773,572	20,014,958
Shpenzime te perllogaritura	10,180,892	2,195,974
Detyrime per taksa ndaj punonjesve	9,892,790	9,049,809
Detyrime per Paga e punojesve	4,295,708	1,158,443
Detyrime te tjera per Taksa	602,268	516,568
Debitore&Kreditore te tjere	53,323	27,029
Totali	<u>40,798,553</u>	<u>32,962,781</u>

29. HUAMARRJET

Huamarrjet më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
<i>Principal</i>		
Kredi Bankare	-	-
Overdrafte Bankare	109,873,730	60,380,000
Totali	<u>109,873,730</u>	<u>60,380,000</u>
<i>Huatë sipas maturimit</i>		
Afatshkurtër (deri në një vit)	109,873,730	60,380,000
Afatgjatë (mbi një vit)	-	-
Totali	<u>109,873,730</u>	<u>60,380,000</u>

30. TATIMI MBI FITIMIN E PAGUESHEM

Detyrimi per Tatimin mbi Fitimin më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Detyrime per Tatimin mbi Fitimin	2,059,576	14,434,300
Totali	<u>2,059,576</u>	<u>14,434,300</u>

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

31. PALET E LIDHURA

Tabelat e mëposhtme tregojnë shumën totale të transaksioneve që janë kryer me palët e lidhura në vitin e dhënë financiar. Kompania ka bashkëpunëtorë me filialet e Grupit Alumil. Një numër transaksionesh kryhen me palët e lidhura në rrjedhën normale të biznesit. Këto transaksione kryhen në terma tregtarë dhe me norma tregu:

a) Të pagueshmet dhe të arkëtueshmet tregtare nga palët e lidhura

Te pagueshmet dhe te arkëtueshmet tregtare nga dhe ndaj paleve të lidhura janë paraqitur si më poshte:

	31 dhjetor 2022		31 dhjetor 2021	
	Te arkëtueshme nga palet e lidhura	Te pagueshme ndaj paleve të lidhura	Te arkëtueshme nga palet e lidhura	Te pagueshme ndaj paleve të lidhura
Hua nga shoqëria mëmë	-	-	-	-
Hua për shoqëri të tjera të grupit	-	-	-	-
Te tjera nga shoqëria mëmë	71,059,789	-	70,792,972	75,046,678
Te tjera nga shoqëri të grupit	-	-	5,786,355	-
Totali	71,059,789	-	76,579,327	75,046,678

b) Blerjet dhe shitjet me Palët e Lidhura

Blerja dhe shitja e mallrave, aseteve dhe shërbimeve nga dhe ndaj palëve të lidhura janë paraqitur më poshtë:

<i>Blerja dhe shitja në total nga dhe për palët e lidhura</i>	31 dhjetor 2022		31 dhjetor 2021	
	Shitje paleve të lidhura	Blerje paleve të lidhura	Shitje paleve të lidhura	Blerje paleve të lidhura
Shoqëria mëmë	505,609,439	2,348,665,127	260,329,957	1,879,559,287
Shoqëri të tjera të grupit	171,677,594	21,111,446	159,050,011	11,566,712
Totali	677,287,033	2,369,776,573	419,379,968	1,891,125,999

c) Blerjet dhe shitjet me Palët e Lidhura*Blerje Asete dhe inventar*

	31 dhjetor 2022		31 dhjetor 2021	
	Shitje paleve të lidhura	Blerje paleve të lidhura	Shitje paleve të lidhura	Blerje paleve të lidhura
Shoqëria mëmë	505,135,613	2,289,887,666	260,329,957	1,820,739,446
Shoqëri të tjera të grupit	171,677,594	21,111,446	159,050,011	11,566,712
Totali	676,813,207	2,310,999,112	419,379,968	1,832,306,158

d) Blerja dhe shitja e shërbimeve nga dhe për palët e lidhura

	31 dhjetor 2022		31 dhjetor 2021	
	Shitje paleve të lidhura	Blerje paleve të lidhura	Shitje paleve të lidhura	Blerje paleve të lidhura
Shoqëria mëmë	473,826	58,777,461	-	58,819,841
Shoqëri të tjera të grupit	-	-	-	-
Totali	473,826	58,777,461	-	58,819,841

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

32. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA

Çështje ligjore

Shoqëria gjatë rrjedhës së rregullt të aktivitetit të saj është përfshirë në çështje të ndryshme ligjore nën gjykim si paditës dhe palë e paditur nga palë të treta. Shoqëria ka një pritshmëri pozitive për të gjitha çështjet gjyqësore.

Detyrime të mundshme tatimore

Legjislacioni tatimor dhe doganor shqiptar i cili hyri në fuqi ose që konsiderohet si i hyrë në fuqi në fund të 2017, është objekt i interpretimeve të ndryshme përsa i përket zbatimit të tij për transaksionet dhe aktivitetet e Shoqërisë. Rrjedhimisht, pozicioni tatimor i ndërmarrë nga drejtimi dhe dokumentacioni zyrtar i cili mbështet qëndrimet tatimore mund të kundërshtohet me sukses nga autoritetet përkatëse. Periudhat fiskale mbeten të hapura për shqyrtim nga autoritetet për pesë vite kalendarike para vitit të shqyrtimit. Në rrethana të caktuara shqyrtimet mund të mbulojnë periudha më të gjata.

Angazhime kapitale

Shoqëria nuk ka pasur shpenzime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara në datën e raportimit

33. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ndonjë ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullime ose informacione shpjeguese shtesë në këto pasqyra financiare të konsoliduara të konsoliduara.